

# RIMËKËMBJE, GJITHPËRFSHIRJE, QËNDRUESHMËRI

Buletini nr. 07 →

SHKURT 2022



**RINGJALLJE**  
**INVESTIM**  
**MBËSHTETJE**  
**QËNDRUESHMËRI**  
**KOORDINIM**  
**PUNËSIM**  
**MIRËQENIE**  
**BARAZI**  
**JETËSIM**  
**EKONOMI**

# Masa 5 →

## Investimi në infrastrukturë dhe ambient

### Për buletin

Buletini “Rimëkëmbje, Gjithpërfshirje, Qëndrueshmëri” është publikim periodik i Institutit për Politika Zhvillimore – INDEP, përmes të cilit synohet informimi në detaje i qytetarëve të Kosovës rreth zbatimit të masave që i përmban Pako e Ringjalljes Ekonomike. Masat e integruara në këtë pako kanë për qëllim lehtësimin e rimëkëmbjes ekonomike, dhe tejkalimin e problemeve që shkaktoi kjo pandemi, tek qytetarët dhe bizneset. Prandaj rëndësia e kësaj pako në rimëkëmbjen ekonomike të vendit është shumë e madhe.

Ky edicion i buletinit, i shtati me rradhë, do të shtjellojë dhe do të ofrojë informacione shtesë përfshirë këtu edhe analiza sa i përket masës së pestë të Pakos së Ringjalljes Ekonomike. Kjo masë titullohet Investimi në infrastrukturë dhe ambient dhe ka të parapara **100 milionë Euro**. Rëndësia e kësaj mase në avansimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë, shtimin e masave të eficiencës së energjisë dhe mbrojtjen e mjedisit është esenciale dhe rrjedhimisht implementimi i saj lidhet ngushtë me kohën e krizës në të cilën gjendemi.

1

- Mbështetja e Punësimit
- 50 milionë Euro

2

- Ringjallja e Ekonomisë dhe Prodhimit
- 108 milionë Euro

3

- Mbështetja për familjen
- 50 milionë Euro

4

- Mbështetja për publikën
- 112 milionë Euro

5

- Investimi në infrastrukturë dhe ambient
- 100 milionë Euro

## → ÇFARË OFRON MASA E PESTË E PAKOS SË RINGJALLJES EKONOMIKE?

Masa e pestë e Pakos së Ringjalljes Ekonomike synon të avansojë më tutje integrimin e burimeve të ripërtërishtme të energjisë, shtimin e masave të efieciencës së energjisë si dhe të ofrojë mbështetje për zhvillimin e mëtutjeshëm të infrastrukturës rrugore dhe hekurudhore në Kosovë. Përmes fondeve të alokuara për këtë masë, synohet të arrihen disa përfitime siç janë:

Mbrojtja e mjedisit

Zhvillimi i infrastrukturës

Rritja e gjenerimit përmes energjisë së gjelbër

Kursimi i energjisë elektrike

Si sektor shumë të rëndësishëm të vendit, energjia dhe infrastruktura, zhvillimi dhe alokimi i mjeteve për të shtyrë përpara këto sektore është i rëndësishëm së madhe për arsye se sektorët në fjalë sjellin vende të reja të punës, ndihmojnë zhvillimin ekonomik dhe njëkohësisht zvogëlojnë ndikimin negativ në mjedis.

Investimet në sektorin e energjisë janë të domosdoshme për arritjen e proceseve siç është dekarbonizimi. Aktualisht Kosova bazohet në gjenerimin e energjisë përmes termoelektranave Kosova A dhe Kosova B, të cilat gjenerojnë energji elektrike përmes përdorimit të thëngjillit. Si burim fosil që është, thëngjili ka ndikime negative në ambient, dëmton shëndetin e të gjithë organizmave të gjallë dhe njëkohësisht tani më edhe investimet në teknologji të cilat përdorin këto lloj burimi thuajse janë ndaluar dhe nuk financohen as nga Banka Evropiane e Investimeve, Banka për Zhvillim e Këshillit të Evropës dhe Banka Botërore. Benefitet e investimeve në sektorin e energjisë, e sidomos në avansimin e burimeve miqësore me ambientin janë të shumta, duke filluar nga përmirësimi i mjedisit, krijimi i vendeve të reja të punës, afrimi me standardet evropiane si dhe largimi nga burimet fosile.

Investimet në infrastrukturë bëjnë të mundshme një zhvillim ekonomik më të hovshëm. Në periudhën në të cilën gjendemi, me krizën e sjellur nga pandemia COVID-19, zhvillimi ekonomik paraqet një nga faktorët më të rëndësishëm, pasi që njëkohësisht është edhe një nga faktorët më të prekur si pasojë e pandemisë. Lidhjet e reja rrugore dhe hekurudhore përmes zhvillimit të infrastrukturës do të mundësonin qarkullime më të shpeshta të mallrave, krijim të vendeve të reja të punës si dhe të hyra shtesë në ekonominë kosovare. Andaj rëndësia e masës së pestë të Pakos së Ringjalljes Ekonomike është e madhe për shumë sektorë të ekonomisë sonë, e në veçanti për sektorët më të prekur nga pandemia.

## INVESTIMET NË FUSHËN E EFIÇIENCËS DHE ENERGISË ELEKTRIKE →

Të kesh një përzierje të larmishme të burimeve energjetike zakonisht konsiderohet një pjesë e rëndësishme e sigurisë së energjisë, pasi të kesh burime të shumta i lejon një vendi të vazhdojë pa ndërprerje nëse një burim energjie dështon. Diversifikimi i burimeve për gjenerim të energjisë elektrike krijon kushte për shtim të kapaciteteve prodhuese, zhvillon qëndrueshmërinë e sektorit të energjisë e gjithashtu ndihmon procesin e tranzicionit energjetik, pra kalimin nga burimet fosile në burime që janë të ripërtëritshme. Andaj investimet në këtë fushë duhet të koncentrohen në zhvillimin e kapaciteteve të reja, të cilat mundësojnë gjenerim të mjaftueshëm për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve.



Një vend si Kosova, që importon një sasi të madhe energjie duhet të marrë parasysh të gjithë faktorët që mund të pengojnë furnizimin me energji që vjen nga vendi eksportues. Aktualisht Kosova nuk plotëson kërkesën e konsumatorëve të saj për furnizim me energji elektrike, andaj edhe një pjesë të madhe të saj e importon nga jashtë. Koncentrimi i gjenerimit në thëngjill, vjetërsia e termocentraleve dhe politika disa vjeçare kanë shkaktuar që vendi ynë të mos ketë stabilitet energjetik e as siguri të saj.



## PSE TË INVESTOHET NË BURIME TË RIPËRTËRITSHME TË ENERGJISË ELEKTRIKE?

- Burimet e ripërtëritshme janë e ardhmja e sektorit të energjisë elektrike
- Burimet e ripërtëritshme janë miqësore me ambientin dhe emetojnë thujse zero gazra serrë
- Burimet e ripërtëritshme mbështeten nga investitorët e huaj dhe nga Institucionet Ndërkombëtare Financiare
- Burimet e ripërtëritshme janë më të lira se burimet fosile
- Burimet e ripërtëritshme krijojnë diversifikim të burimeve energjetike
- Burimet e ripërtëritshme janë më profitabile në aspektin ekonomik krahasuar me burimet fosile
- Burimet e ripërtëritshme nuk kërkojnë depo për magazinim, e as nuk kërkojnë transportim prej një vendi në një tjetër
- Burimet e ripërtëritshme nuk varen nga çmimet e burimeve fosile, rrejdhimisht nuk janë pjesë e ngritjeve dhe uljeve të çmimeve të burimeve fosile në tregun ndërkombëtar

Efiçenca e energjisë do të thotë të përdorësh më pak energji për të kryer të njëjtën punë dhe në këtë proces, uljen e faturave të energjisë dhe reduktimin e ndotjes. Shumë produkte, shtëpi dhe ndërtesa përdorin më shumë energji sesa kanë nevojë në të vërtetë, përmes joefikasitetit dhe humbjes së energjisë. Efiçasiteti i energjisë është një nga mënyrat më të lehta për të eliminuar mberurinat e energjisë dhe për të ulur kostot e energjisë. Është gjithashtu një nga mënyrat me kosto më efektive për të luftuar ndryshimet klimatike, për të pastruar ajrin që thithim, për të ndihmuar familjet të përmbushin buxhetet e tyre dhe për të ndihmuar bizneset të përmirësojnë linjat e tyre përfundimtare. Efiçenca e energjisë është metodologji e cila ndihmon kursimin e energjisë elektrike por edhe kursen ekonominë e gjithësecilit person që aplikon masa për të kursyer energjinë elektrike. Ndërrimi i poçave elektrik nga inkandeshent në poça LED, izolimi i shtëpisë, vendosja e dritareve treshtrësore e shumë masa të tjera paraqesin masa për shtimin e efiçencës së energjisë. Përmes këtyre masave mbrojmë ambientin, ulim konsumin e energjisë dhe ndihmojmë zvogëlimin e ndryshimeve klimatike.



## PSE TË INVESTOHET NË EFIÇIENCË TË ENERGJISË? →

- Përmes investimit në efikasitet të energjisë zvogëlohet konsumi i panevojshëm i energjisë elektrike
- Kthimi i investimit përmes aplikimit të masave të efikasitetit është i favorshëm ekonomikisht, duke ditur çmimet e energjisë elektrike në treg
- Investimi në masa të efikasitetit të energjisë krijon komoditet të njëjtë duke shfrytëzuar sasi më të vogël të energjisë elektrike
- Zvogëlimi i ndikimit në ndryshimet klimatike dhe ruajtja e ambientit





# INVESTIMET NË INFRASTRUKTURË RRUGORE E HEKURUDHORE

Investimet në infrastrukturë mbulojnë shpenzimet për ndërtimin e infrastrukturës së re transportuese dhe përmirësimin e rrjetit ekzistues. Investimet në infrastrukturë janë një përcaktues kyç i performancës në sektorin e transportit. Infrastruktura e brendshme përfshin rrugët, hekurudhat dhe aeroportet dhe merr parasysh të gjitha burimet e financimit. Infrastruktura efiçente e transportit ofron përfitime ekonomike dhe sociale si për ekonomitë e përparuara ashtu edhe për ato në zhvillim duke bërë të mundur:

**Përmirësimin  
e aksesit  
në treg dhe  
produktivitetit**

**Sigurimin e  
zhvillimit të  
balancuar  
ekonomik  
rajonat**

**Krijimin e  
punësimit**

**Promovimin e  
lëvizshmërisë së  
punës**

**Lidhjen e  
komuniteteve**

**Krijimin e  
vendeve të  
punës**

Kosova ka lidhje rrugore me të gjitha vendet fqinje. Përmes kësaj infrastrukture rrugore, Kosova siguron transportim të mallrave, bashkëpunim rajonal, zhvillim ekonomik, zhvillim të turizmit dhe zhvillim të aktiviteteve tjera të cilat janë thelbësore për mbarëvajtjen e të gjithë aktiviteteve jetësore. Mirëpo gjendja e rrugëve nuk është adekuatë dhe e kënaqshme, andaj investimet në këtë sektor do të nënkuptonin shtim të të mirave ekonomike dhe përfitimeve tjera, siç janë investimet nga investitorët e huaj. Masa e pestë e Pakos së Ringjalljes Ekonomike parasheh investime në këtë sektor, andaj mjetet e alokuara për këtë masë do të ndikojnë në përafrimin e bizneseve të reja në vendin tonë, e rrjedhimisht edhe krijimin e vendeve të reja të punës.

Infrastruktura hekurudhore e Kosovës është shumë pak e zhvilluar dhe është e kufizuar vetëm brenda territorit të Kosovës, pasi që lidhja me shtetet fqinje përmes kësaj infrastrukture ka kohë që është jofunksionale. Operacionalizimi i rrugëve të reja hekurudhore, dhe vitalizimi i infrastrukturës aktuale do të bashkonte dhe afronte Kosovën edhe më tepër me vendet fqinje duke mundësuar kështu lidhje të reja transportuese dhe lehtësim të bashkëpunimit me vendet e rajonit. Infrastruktura hekurudhore ka kohë që është lënë e prapambetur, andaj përmes kësaj pako ekonomike dhe investimeve të parapara do të mund të ringjalljes ky sektor infrastrukturor.

Në territorin e Kosovës kemi gjithsej 333 km binar hekurudhor për transport. Bartja e udhëtarëve dhe transporti i mallrave paraqet aktivitetet kryesore që zhvillon përmes kësaj infrastrukture. Përmirësimi i rrjetit aktual dhe zgjerimi i tij do të mundësojnë zhvillim të shtuar ekonomik dhe lidhje të reja të bashkëpunimit, në mënyrë që edhe investimet e huaja të jenë më të favorshme edhe për vendin tonë por edhe për investitorët. Rritja e investimeve ka ndërlidhje të ngushtë me infrastrukturën, pasi që infrastruktura është sektori i cili mundëson mbarëvajtjen, rritjen dhe shpërndarjen e mallrave, udhëtarëve si dhe lidhjen me rajonin por edhe më gjerë.



## PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

- Të fillohet operacionalizimi i masës së pestë të Pakos së Ringjalljes Ekonomike. Deri më tani, kjo masë nuk ka filluar të implementohet, ani pse investimet në sektorët që parasheh kjo masë janë sektorët më të rëndësishëm të vendit. Implementimi dhe alokimi i mjeteve që ka kjo masë të ndara, do të mundësonte vende të reja të punës, përmirësim të jetesës, kursim të energjisë elektrike si dhe diversifikim të burimeve të energjisë.
- Të investohet në kapacitete të reja gjeneruese me bazë të prodhimit në burime të ripërtëritshme të energjisë. Kriza energjetike që ka kapluar Kosovën, ka përgjigje kryesore mos investimin në burime miqësore me ambientin dhe fokusim në gjenerimin e energjisë elektrike përmes shfrytëzimit të thëngjillit. Andaj duke pasur në fokus dekarbonizimin, tranzicionin energjetik, sigurinë energjetike dhe zhvillimin ekonomik, Kosova duhet të ndërmarrë politika dhe të bëjë investime të cilat janë në favor të sektorit të burimeve të ripërtëritshme të energjisë.
- Të përfshihen politika dhe subvencione për shtim të masave të eficientësisë së energjisë. Në shumë vende, përmes pakove të gjelbra të rimëkëmbjes janë financuar dhe ndihmuar qytetarët që kanë investuar në eficientësi të energjisë, si një mënyrë e kursimit të energjisë elektrike dhe kursim i të hollave. Ndër të tjera, ky sektor siguron edhe shumë vende të reja të punës, e cila paraqet një metodë të rimëkëmbjes nga pandemia COVID-19. Qeveria e Kosovës të intensivifikojë investimet dhe subvencionimet, pasi që një nga faktorët e krizës aktuale energjetike është edhe konsumi i tepërt i energjisë elektrike.
- Investimet në infrastrukturën hekurudhore dhe rrugore të fokusohen në zhvillimin e rrugëve të reja dhe përmirësimin e atyre aktuale. Krijimi i rrugëve të reja do të krijonte më shumë mundësi bashkëpunimi dhe zhvillimi, e gjithashtu do të tërheqte investitorët e huaj që të investonin në vendin tonë. Në të njëjtën kohë, vitalizimi i rrjetit hekurudhor do të paraqiste vlerë të shtuar të sektorit të infrastrukturës të Kosovës, andaj investimet e menjëhershme do të nënkuptonin zhvillim ekonomik më të shpejtë dhe mundësi të reja për qytetarët e vendit tonë.



**B | T | D** The Balkan Trust  
for Democracy  
A PROJECT OF THE GERMAN MARSHALL FUND

“Ky projekt mbështetet nga Balkan Trust for Democracy (BTD) një projekt i Fondit Gjerman Marshall të SHBA-ve dhe popullit amerikan përmes Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) dhe zbatohet nga Instituti për Politika Zhvillimore – INDEP. Pikëpamjet dhe opinionet e shprehura nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet apo opinionet e BTD, GMF, USAID ose Qeverisë së SHBA-së.”